



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NDËRRMARJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____prot.

Ballsh, më ____ / ____ / 2022

MIRATOHET
DREJTOR
Bilbil VELIAJ

AKTI-TEKNIK

Mbi hartimin e specifikimeve teknike, përcaktimin e sasisë dhe përlogaritjen e vlerës limit për objektin “ Blerje kontenjerë për mbetjet urbane ”

Ky akt teknik u hartua nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, sipas urdhërit të brendshëm të Drejtorit të Ndërmarrjes nr. 47 , datë 25 /08 /2022 (shkresa nr. 136 regj. Date 25/08/2022) Për ngritjen e komisionit , përlogaritjen e sasisë , hartimin e specifikimeve teknike, vlerës limit për zërin dhe afatin e realizimit/lëvrimit për zërin “ **Blerje kontenjerë për mbetjet urbane**”

Në zbatim të urdhërit të brendshëm dhe legjislacionit në fuqi, si dhe duke marrë në konsideratë modelin e kontenierit të mbetjeve urbane, i cili duhet të jetë i përshtatshëm për tu ngarkuar nga kamionët teknologjikë të pastrimit që disponon Ndërmarrja e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Mallakastër.

Komisioni paraprkasht u fokusua në hartimin e specifikimeve teknike për modelin, dimensionet, kapacitetin mbajtës dhe aksesorët që duhet të kenë kontenierët e mbetjeve (kazanët).

Më poshtë jepen në mënyrë të detajuar specifikimet teknike:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti: “ Blerje kontenjerë për mbetjet urbane”

Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo reference të ndonjë marke apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përvenc rasteve kur nuk egziston një mënyrë e mjaftueshme, e sakt apo e kuptueshme, e

përshkrimit të kërkesave, me kushte që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Më poshtë jepen në mënyrë të detajuar specifikimet teknike:

Kapaciteti mbartës: 1100 litra – 500kg – 1.1 m³.

Lartësia 1280 mm, gjerësia 960 mm dhe gjatësia 1360 mm.

Materiali i prodhimit të jetë llamarinë e zinguar me spesor 1-4 mm.

Trupi i kontenierit të jetë i ndërtuar me llamarinë celiku e tipit 08 Kp me stampimë në të ftohtë .

Ekstra përforcim i bazës së rrotës, i ngjitur te kontenieri,dhe mbështetës me spesor 2mm.

Të jenë te pajisur me forma për tu kapur nga dy tipe makinash teknologjike, dhe me dy doreza anësore për tërheqje.

Të jenë të pajisur me sistem kullimi fundor për derdhjen e lëngjeve të grumbulluara nga mbetjet apo gjatë larjes.

Profili i përdorur për kornizën e sipërme të kontenierit (40 x 30 x 1.5 mm)

Kapaku metalik me përforcues të tërthortë për ekstra rezistencë dhe profil i drejtë me kanale për rrjedhie të ujrave te shiut.

Rrotat rezistente me celik të galvanizuar në qëndër dhe me unazë gome, rezistente në pjesen e kontaktit me tokën.

4 rrota të kthyeshme me kuzhineta, ku kapaciteti mbajtës për rrotë të jetë 300 kg, nyje të lëvizëshme me rrotullim 360 grad.

Rrotat të jenë të veshura me gominë plastike solide 200 mm me suport llamarine, suporti të jetë i përforcuar me llamarinë trekëndësh.

Kazanët duhet të durojnë kushtet klimaterike të ndryshme, për të gjithë përbërësit, temperatura nga -20 deri +50 gradë.

Struktura e ndërtimit duhet të garantojë një mbajtje peshe deri në 500 kg, pa pësuar asnjë deformim permanent.


Modeli i kapjes së kazanit Attaco Bologna, sipas normativës UNI EN 840 (UNI 10571), dhe i pajisur me Certifikatë cilësie ISO 9001-2015.

Ngjyra e kontenierëve të jetë metalizato e galvanizuar në të nxehtë.

Kontenierët të jenë të pajisur me forma për tu kapur nga dy tipe makinash teknologjike, dhe me dy doreza anësore për tërheqje. Kjo për faktin, se makinat teknologjike që disponohen janë të ndryshme dhe për këtë arsye kërkohet që kontenierët të përshtaten për të dyja tipet e makinave teknologjike në rast avarie.

Parametrat e kontenierëve janë vendosur sipas përmasave që kërkon aparati i instaluar në mjetet teknologjike. Plotësimi i paramertave të kërkuar është thelbësor pasi mospërshtatja e tyre me aparatën përkatës të instaluar në makinat teknologjike, nxjerr jashtë funksionit këto të fundit dhe në këto kushte plotësimi i parametrave të vendosura është i domosdoshëm për tu plotësuar.

Për detaje më të qarta më poshtë jepen fotot e kontenierëve (kazanët)



- Në lidhje me grafikun e lëvrimit:

Mallrat duhet të lëvrohen brenda 15 ditëve nga data e lidhjes së kontratës,

Ky akt ka 3 (tre) fletë dhe mbahet në 3 (tre) kopje, një kopje e të cilit dorëzohet në sekretari/protokoll pranë Ndërrmarjes së Shërbimeve Publike.

KOMISIONI: